



**BASHKIA TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 20, datë 20.02.2017

Për

**“MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË STREHIMIT
“SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË, HARTUAR SIPAS UDHËZUESIT
OPERACIONAL “**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për Programet Sociale të Strehimit” (i ndryshuar), Memos nr. 37050, datë 02.12.2016, për “Projekt-Propozimin për “Subvencionimin e interesave të kredisë përmes buxhetit të Bashkisë Tiranë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Programit Social të Strehimit "Subvencionimi i Interesave të Kredisë" dhe zbatimin e tij sipas udhëzuesit operacional, bashkëlidhur këtij vendimi si Shtojca 1.
2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi do të përballohen nga fondi i Aparatit të Bashkisë për programin "Strehimi dhe Planifikim i Territorit", parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2017 .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI



BASHKIA E TIRANËS

Udhëzues Operacional

Program Social Strehimi i Bashkisë Tiranë

“Për subvencionimin e Interesave të Kredisë”

Shkurt 2017

1. Hyrje

Gjatë vitit 2014 Ministria e Zhvillimit Urban, me mbështetjen e PNUD-it, ka realizuar dy studime të cilat janë fokusuar në analizën e situatës së strehimit social dhe vlersimit të nevojave të strehimit social në Shqipëri. Studimet hodhën dritë mbi një sërë problematikash dhe sfidash me të cilat hasen sot politikatat social në shkallë vendi. Konkretisht u identifikuan problematika në kuadrin e pamjaftueshëm ligjor, në studimet e pakta të nevoja për programe sociale dhe kryesisht në fushën e strehimit social, mungesa e statistikave reale për nevojshëmërinë e programeve të strehimit social, mundësitë dhe kapacitetet për aplikimin e programeve të strehimit nga pushteti vendor, mungesa e fondeve qëndore dhe vendore për programe të strehimit etj.

Nisur nga problematikat e evidentuara nga studimi në shkallë vendi, si dhe nga situata reale e trashëguar në Bashkinë e Tiranës, konstatohet se problematika kryesore për hartimin e politikave dhe programeve efektive të strehimit social është mungesa e të dhënave sistematike dhe analizave të cilat mbështeten në të dhënat, kjo vjen si rezultat i faktit se:

Së pari, njësitë vendore nuk kanë një sistem të qëndrueshëm që u shërben për grumbullimin e të dhënave. Nga 27 bashki të cilat u pyetën rreth sistemit të grumbullimit të të dhënave në vitin 2014, 12 raportuan se nuk përdorin asnjë program për regjistrimin e të dhënave të aplikantëve dhe 15 bashki përdorin programin Excel.

Së dyti, pjesa më e madhe e njësisve vendore nuk realizojnë analiza me qëllim identifikimin e nevojës për strehim si dhe identifikimin e burimeve lokale të cilat mund të mobilizohen me qëllim plotësimin e nevojave.

Së treti, pjesa më e madhe e vëmendjes fokusohet në sigurimin e strehimit social; pas kësaj, pak dihet rreth impaktit që kanë programet e strehimit social në mirëqenien e familjeve. Zakonisht, specialistët e strehimit e përditësojnë informacionin kur u kërkohet t'i japin të dhëna këshillit bashkiak ose kur zbatohet një program i ri social për strehimin por përtej kësaj, të dhënat nuk përdoren për ndonjë qëllim tjetër

Për sa më sipër, nevojitet ndërmarrja e disa hapave paraprak për hartimin e një program të ri të strehimit social siç janë:

- Ngritja e një sistemi të dhënash për llojshmërinë e kërkesave për programe të strehimit social i cili do të mundësojë grumbullimin dhe më tej analizimin e të dhënave në mënyrë periodike .
- Sigurimi i të dhënave në disa nivele – të dhëna që fokusohen në nevojën për strehim social, situatën e strehimit të grupeve të përjashtuara. Kjo do të kërkojë krijimin e infrastrukturës

së nevojshme për grumbullimin e të dhënave dhe më tej forcimin e kapaciteteve vendore mbi mënyrën si të grumbullojnë, analizojnë, dhe më tej përdorin të dhënat.

Ndjekja e ecurisë së kërkesave për strehim social, ka implikuar ngritjen e një database të posaçëm. Si fillim, Bashkia e Tiranës nëpërmjet drejtorisë përkatëse fokusoj vëmendjen në mbledhjen e të dhënave lidhur me kërkesat për subvencionimin e interesave të kredisë për blerjen e apartamenteve të banimit, me qëllim analizimin e tyre për efekt hatimi dhe miratimi i një programi specifik i cili është tashmë objekt këtij udhëzuesi.

Të dhënat e mëposhtme janë marrë nga programet e ngjashme të miratuara dhe buxhetuara nga pushteti qëndror dhe të zbatuara nga pushteti vendor /Bashkia e Tiranës.

Nga viti 2009 deri në vitin 2013, përfitues në programin banese me kosot të ulët janë shpallur 2.045 familje. Ndër vite listat e aplikuesve përfitues janë miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Nga statistikat e nxjerra nga Drejtoria e Strehimit Social për vitin 2013 rezulton:

Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 11 datë 28.02.2013 me 179 përfitues :

85 përfitues garsionere	* 3 704 400 (masa e kredise qe perfitojne) = 314 874 000
48 përfitues 1+1	*4 410 000 (masa e kredise qe perfitojne) = 211 680 000
35 përfitues 2+1	*5 468 400 (masa e kredise qe perfitojne) = 191 394 000
11 përfitues 3+1	*7 056 000 (masa e kredise qe perfitojne) = 77 616 000

Shuma = 795 564 000

Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 34 datë 18.11.2013 me 679 përfitues :

255 perfitues garsionere	* 3 704 400 (masa e kredise qe perfitojne) = 944 622 000
95 perfitues 1+1	* 4 410 000 (masa e kredise qe perfitojne) = 418 950 000
93 perfitues 2+1	* 5 468 400 (masa e kredise qe perfitojne) = 508 561 200
36 perfitues 3+1	* 7 056 000 (masa e kredise qe perfitojne) = 254 016 000

Shuma = 2 126 149 200

Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 44 date 18.12.2013 me 201 përfitues :

95 garsionere	* 3 704 400 (masa e kredise qe përfitojne) = 351 918 000
50 përfitues 1+1	* 4 410 000 (masa e kredise qe perfitojne) = 220 500 000
38 përfitues 2+1	* 5 468 400 (masa e kredise qe perfitojne) = 207 799 200
18 përfitues 3+1	* 7 056 000 (masa e kredise qe perfitojne) = 127 008 000

907 225 200

Ndërkohë, **për periudhën 01.01.2016 deri me 30.12.2016** janë paraqitur rreth 1.800 kërkesa për programet sociale të strehimit për kredi të buta të mbuluara me fondet e pushtetit qendror. Për efekt studimi të natyrës së kërkesave, Drejtoria e Strehimit Social shqyrtoj një kampion prej 68 dosjesh të cilat plotësonin dokumentacionin e kërkuar. Nga ky kampion aplikimet orientonin kërkesën dhe mundësinë e mbështetjes financiare në strukturat e banimit të ilustruara më poshtë:

Garsionere	32 aplikime
1+1	22 aplikime
2+1	7 aplikime
3+1	7 aplikime

Për sa më sipër, duke konsideruar trendin në rritje të kërkesave për subvencionimin e interesave të kredisë për blerjen e apartamenteve të banimit, Bashkia Tiranë hartoi një program specifik, tërësisht i buxhetuar prej saj, për këtë qëllim.

2. Misioni dhe Elementet kyç

2.1. Misioni

Programet sociale për strehim janë programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore. Më specifikisht, programi social i strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë” synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.

2.2 Baza ligjore

Hartimi dhe zbatimi i programeve sociale për strehim mbështetet në Ligj nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për Programet Sociale Të Strehimit” (i ndryshuar) (në vijim referuar si “**Ligji 9232/2004**”) dhe aktet nënligjorë për zbatimin e tij, të cilët synojnë të përcaktojnë tërësinë e rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, të administrimit dhe të planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit. Sipas dispozitave ligjore programet sociale të strehimit janë 3:

1. Programe të banesave sociale me qira,
2. Programe të banesave me kosto të ulët.
3. Programe të pajisjes së truallit me infrastrukturë.

Në bazë të Ligjit 9232/2004 zbatimi dhe implementi i programve sociale të strehimit mund të bëhet nga organet e pushtetit qendror dhe/ose nga organet e pushtetit lokal.

Në neni 30 të Ligjit 9232/2004 parashikohet shprehimisht se “*programi i banesave më kosto të ulët mund të financohet nga :*

1. *fondet buxhetore, që jepen çdo vit për programe strehimi nëpërmjet ministrisë që mbulon fushën e strehimit;*
2. *kontributet nga donatorë të ndryshëm;*
3. *fonde nga buxheti i njësisë së qeverisjes vendore.*

Sipas nenit 35 pika a dhe b i Ligjit 9232/2004 “*funksionet të njësisë të qeverisjes vendore janë edhe identifikimi i nevojave për strehim, sipas programeve të hartuara në bazë të këtij ligji për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre dhe hartimi i projekteve trevjeçare, bazuar në burimet financiare që ato zotërojnë*

Me fjalë të tjera, miratimi dhe financimi i programeve sociale buxheti i njësisë së qeverisjes vendore është konsideruar si një nga mënyrat alternative për të integruar dhe fuqizuar politikat e mbështetjes sociale të hartuara në nivel qeverisje qendrore.

Në nenin 9 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, për “*Vetëqeverisjen Vendore*” (në vijim referuar si “**Ligji 139/2015**”), përcaktohet se:” *njësitë e vetëqeverisjes bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra*”.

Pika 1.3 e nenit 9 të Ligjit 139/2015 përcakton të drejtën dhe përgjegjësinë e njësisë së qeverisjes vendore për mbledhjen e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve për përmbushjen e funksioneve saj, si dhe të hartojë, miratojë dhe zbatojë buxhetin e saj

Sipas nenit 24 të Ligjit 139/2015 njësitë e qeverisjeve vendore ushtrojnë funksionet e tyre në fushën e shërbimeve sociale. Njësitë e qeverisjeve vendore janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve nëpërmjet “... *krijimit dhe administrimit të shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj...*” si dhe nëpërmjet “... *krijimit, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj*”.

Në nenin 54 të Ligjit 139/2015, ndër të tjera, përcaktohet se është kompetencë e Këshillit Bashkiak të miratojë normat, standardet dhe kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik.

Nisur nga ky fakt, nga kërkesat e paraqitura, si dhe nga orientimi i Bashkisë së Tiranës për ndërmarrjen e politikave të reja me karakter vendor në fushën e mbrojtjes social dhe strehimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale propozoj iniciimin e një programi social strehimi për subvencionimin e interesave të kredisë me kohëzgjatje 1 vjeçare, për individët dhe familjet që nuk janë në gjendje të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore.

2.3. Përfituesit potencial dhe kohëzgjatja e programit

Përfitues potencial të programit social të strehimi për krijimin e kredive me kushte lehtësuese për blerjen e banesave të para **do të jenë individët ose familjet**, me synim përmirësimin e kushteve të cilësisë së jetesës së tyre. **Përparësi do t'u jepet individëve të rinj dhe familjeve që në përbërje kanë një çift të ri.** Këto familje kanë më tepër akses në kreditim dhe mund të përballojnë e masës së kredisë, për arsye të moshës së re dhe nivelit të të ardhurave që mund të disponojnë.

Për efekt të zbatimit të këtij programi:

(i) **“familje”** do të kondiderohet një grup individësh që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore, si edhe marrëdhëniet prindër fëmjë, marrëdhëniet midis anetarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë që jetojnë në të njëjtën strehë.

(ii) **“individë”** do të konsiderohet një person që sipas statusit të çertifikatës së gjendjes familiare në datën e aplikimit rezulton të jetë Kryefamiliar i vetëm.

Programi do të ketë një kohëzgjatje një vjeçare dhe numri i përgjithshëm i përfituesve të cilët do të mbështeten financiarisht nuk do të tejkalojë 1.000 (një mijë) familje.

Për efekt të zbatimit të këtij programi me **“kohëzgjatje një vjeçare”** do të nënkuptohet harkut kohor gjatë të cilit aplikantët do të kenë mundësi të paraqesin kërkesat e tyre sipas procedura dhe kriterëve të detajuara në vijim.

Në të kundërt, angazhimi financiar i Bashkisë së Tiranës në zbatim të këtij programi do të ketë një kohëzgjatje 15 -20 vjeçare, në varësi të kredive hipotekore të akredituara për secilin përfitues.

2.4. Masa e subvencionit të interesave të kredisë dhe mbulimi financiar

Masa e subvencionit të interesave të kredisë, për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga ky program, do të jetë e barabartë me diferencën që rezulton midis interesit vjetor të kredisë në tregun e lirë, sipas marrëveshjes së nënshkruar me bankën, me interesin prej 3% që paguan familja mbi principalin e kredisë.

Financimi i programit është parashikuar tashmë në buxhetin e vitit 2017 në shumën 95 milionë lekë.

Fondi i nevojshëm është funksion i:

- Numrit të përfituesve në total dhe për cdo tipologji banese
- Normës së interesit të kredisë
- Periudhës së shlyerjes së kredisë

Përlllogaritjet janë bazuar në një numër maksimal përfituesish prej 1000 familje/përfitues. Bazuar në të dhënat historike të përfituesve për vitet 2009-2013, është supozuar, për efekt përlllogaritjesh, pesha specifike për cdo tipologji apartamenti në: rreth 51% përfitues për garsoniere; 22% për apartamente 1+1; 20% për apartamente 2+1 dhe 8% për apartamente 3+1.

Norma e interesit, janë objekt i procesi i hapur i konkurrimit ndërmjet bankave, ndaj në përlllogaritje është përdorur mesatarja e normave të publikuara në sistemin bankar, në momentin e planifikimit, prej 5.5% (tribor+2.5%).

Periudha e shlyerjes së kredisë është supozuar 20 vjet.

Bazuar në të dhënat e supozuara si më sipër, fondi i nevojshëm për të gjithë periudhën e shlyerjes së kredisë, ndryshon në vitet në vijim si më poshtë:

Buxheti i nevojshëm ulet me 3% në vitin e dytë, me 5% në vitin e pestë, me 6% në vitin e dhjetë, me 13% në vitin e pesëmbëdhjetë dhe në vitin e fundit është rreth 36% i fondit të vitit të parë.

Ky ndryshim i referohet vetëm efektit sipas planit të amortizimit të kredive, sipas të cilit, në vitet e para të kredisë nëpërmjet këstit mujor paguhet më shumë interes dhe më pak principal. Ky raport përmbysset me kalimin e viteve duke shkuar në ulje për interesin.

Fondi vjetor i Bashkisë së Tiranës, për mbulimin e interesave të kredive, mund të ndryshojë gjithashtu për vitet në vijim, për efekt të ndryshimit të normës së tregut të kredisë si dhe në varësi të numrit të përfituesve për secilën tipologji apartamenti (garsoniere; apartamente 1+1; apartamente 2+1 apartamente 3+1), brenda numrit total prej 1000 përfituesish.

Bashkia e Tiranës, planifikon çdo vit në buxhetin e programit, brenda fondit total, një kontigjencë për të përballuar risqet e mundshme të tregut.

Kohëzgjatja e programit për efekt aplikimi do të jetë një vit, me mundësi ri-miratimi për vitet e ardhshme, në varësi të numrit të kredive të suksesshme që do të realizohen në vitin e parë dhe mundësive financiare të Bashkisë së Tiranës për vitet e ardhshme.


2.5. Shtrirja gjeografike

Programi synon të përfshijë dhe mbështesë të gjithë individët dhe familjet rezidente në territorin e Bashkisë së Tiranës.

3. Hapat për Zbatimin e Programit dhe Strukturat Përgjegjëse

Hapat e nevojshëm për identifikim dhe miratimin e listës së aplikantëve përfitues në kuadër të programit social të strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë” ilustrohen skematikisht në vijim:

Tabela nr. 1 – Hapat për zbatimin e programit



Zbatimi i programit social të strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë” do të kryesohet nga Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale dhe do të zbatohet në bashkëpunim me Drejtori të Përgjithshme të Bashkisë, të listuara si më poshtë vijon:

- Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik
- Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar
- Drejtorja e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit
- Drejtorja e Përgjithshme e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun

- Njësitë Administrative.

Për zbatimin e këtij programit, strukturat përgjegjëse do të kryejnë detyrat e përshkruar në vijim:

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale** – harton thirrjen për aplikim;
- Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun** – kryen njoftim publik në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale;
- Drejtoria e Komunikimit me Qytetarët dhe Njësitë Administrative** – Drejtoria e Komunikimit me Qytetarët pranon formularët e aplikimit sipas afateve të percaktuara në thirrje. Njësitë Administrative plotësojnë formularin e strehimit i cili është pjesë e dokumentacionit të kërkuar;
- Drejtoria e Strehimit/ Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale** – kryen procesin paraseleksionues të aplikimeve të paraqitura duke përzgjedhur kërkesat me dokumentacion të plotë, që plotësojnë kushtet bazë për aplikim percaktuar në pikën 6 në vijim.
- Komisioni i Strehimit i ngritur me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 08.11.2005 (i ndryshuar)** - shqyrton aplikimet dhe përzgjedh aplikantët në bazë të sistemit të pikëzimit. Pas përfundimit të shqyrtimit të aplikimeve komisioni në fjalë harton një Raportit Përmbledhës të cilin ia paraqet për miratim Kryetarit të Bashkisë.
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale** – në bazë të Raportit Përmbledhës të miratuar nga Kryetari i Bashkisë harton projekt-vendimin për miratimin e listës së përfituesve e cila i paraqitet për miratim Këshillit Bashkiak;
- Këshilli Bashkiak** – miraton listën e përfituesve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale** – i komunikon Bankës listën e përfituesve të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale** – monitoron dhe i raporton Kryetarit të Bashkisë ecurinë, duke kërkuar nga banka azhurnim të vazhdueshmëm për kreditë e alokuara.

4. Fushata informuese dhe njoftimi i thirrjes për aplikim

Një fushatë informuese 1 mujore do të organizohet duke pasur si objektiv thirrjen e aplikantët e pranueshëm, përfitues potencial të programit.

Fushata informuese do të krijohet dhe zhvillohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale.

Njoftim Publik duhet të përfshijë informacion për tërësinë e procesit të aplikimit dokumentacionin e kërkuar dhe kriteret e pranueshmërisë dhe hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij udhëzuesi. Njoftimi do të botohet nga Bashkia në të paktën 2 gazeta ditore si dhe të publikohet në faqet e internetit të Bashkisë.

Njoftim Publik për programin e “Subvencionimit të interesave të kredisë” duhet të hidhet online, si edhe të jetë në dispozicion në kopje të printuara në zyrat e pritjes së qytetarëve pranë Bashkisë së Tiranës.

Të gjitha publikimet, njoftimet dhe materialet e tjera do të ofrojnë informacion për aplikantët e interesuar mbi afatet e dorëzimit dhe procesin e përzgjedhjes do të gjenden pranë Zyrave të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës ose pranë Njësive Administrative.

Programi fillon efektivisht në datën e publikimit të thirrjes së parë. Gjatë kohëzgjatjes një vjeçare të programit do të publikohen të paktën tre thirrje. Tendencialisht thirrjet do të organizohen në një distancë kohe prej 3 ose 4 muajsh nga njëra tjetra. Data e përfundimit të programit nuk do të çenojë zhvillimin dhe ezaurimin e procedurave të nisura në kuadër të thirrjes së fundit (dorëzimin e aplikimeve, shqyrtimin e tyre etj.).

Njoftim i parë Publik do të shpallet vetëm pasi të kenë përfunduar procedurat e përzgjedhjes dhe lidhja e marrëveshjes me bankën.

5. Pranimi i aplikimeve dhe dokumentacioni i kërkuar

Kërkesa për aplikim së bashku me dokumentacionin e kërkuar duhet të dorëzohen në kopje origjinale personalisht pranë Zyrave të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës ose nëpërmjet postës në një zarf të vulosur që drejtohet si më poshtë: *“Në vemendje të:” Drejtorisë së Strehimit - Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Bashkia e Tiranës ...”* .

Çdo aplikant së bashku me kërkesën e tij duhet të dorëzojë edhe dokumentat si më poshtë:

- (i) Formulari i strehimit i plotësuar pranë Njesisë Administrative në të cilën aplikantit ka vendbanimin;
- (ii) Çertifikatën e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare;
- (iii) Vërtetimin për vendbanimin në bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;
- (iv) Vërtetimin e të ardhurave neto të familjes/individit;

- (v) Dokumentacionin përkatës nga punëdhënësi për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;
- (vi) Dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
- (vii) Vërtetimin nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të qeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në pagesat për personat me aftësi të ku fizuar;
- (viii) Vërtetimin nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;
- (ix) Vërtetimin nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension;
- (x) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis, që mund të përdoret si e till;
- (xi) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit;
- (xii) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
- (xiii) Dokumentin zyrtar të celebrimit dhe certifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja;
- (xiv) Vendimin e gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara;
- (xv) Vërtetimin përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit;
- (xvi) Vërtetimin e komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar, për individë me aftësi të kufizuara;
- (xvii) Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", punëtor emigrant" dhe "azilkërkues";
- (xviii) Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Policisë së Burgjeve;
- (xix) Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse për viktimat e dhunës në familje punëtor emigrant" dhe "azilkërkues";
- (xx) Deklarate noteriale që lëshohet nga kryefamiljari që shprehet se është dakort që kredia të lëvrohet për aplikantin që rezulton i përfshirë në formularin e strehimit.

6. Kriteret bazë për aplikim dhe paraseleksionim

Kriteret bazë për paraseleksionimin e kërkesës së paraqitur nga individët/familjet e interesuara për të përfituar nga programi social i strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë”, do të jenë:

- ✓ individë të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë mbushur moshën 18 vjeç;
- ✓ familjet të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kanë në pronësi një banesë;
- ✓ familjet që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;
- ✓ familjet që zotërojnë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar në pikën 8, Tabela nr. 3 në vijim.

Drejtoria e Strehimit shqyrton dhe paraseleksionon kërkesat e paraqitura mbi bazën e këtyre kriterëve dhe plotësisë së dokumentacionit shoqëruar, të përcaktuar në pikën 5 më sipër.

7. Kriteret për përzgjedhjen e përfituesve – Formula e Pikëzuar

Vlerësimi i aplikimeve të paraseleksionuara dhe dokumentacionit shoqërues do të kryhet nga Komisioni i Strehimit mbi bazën e një sistemi pikëzimi, të paraqitur në Tabelën nr. 2 më poshtë.

Tabela nr. 2 - Formula e Pikëzimit për aplikantët në programin social të strehimit për “Subvencionimin e Interesave të Kredisë”

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	20
A	Nuk disponon apartament në pronësi	3
B	Banojnë në banesa në rrezik shembje	2
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	2
Ç	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore, ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;	5
D	Familje të shpronësuara të cilat kanë dalë të pastreha për shkak të zbatimit të ligjit nr. 82/2012 “Për miratimin e <u>Aktit Normativ nr. 3</u> , datë 01.08.2012, apo nga investime publike të kryera nga Bashkia e Tiranës.	8
1.2	KUSHTET FAMILJARE	28
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë	5
B	Përbëhen nga familje të reja që kanë në ngarkim persona me aftësi të kufizuar apo persona në pension por pa apartament tjetër banimi apo pasuri të tjera të ngjashme	3
C	Familjet me më shumë se tre fëmijë	5
Ç	Familje të reja ku çifti bashkëshortëve ka moshe të përbashkët totale deri 70 vjeç.	15
1.3	KUSHTET SOCIALE	22
A	Persona me aftësi të kufizuar	5

B	Persona me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç	5
C	Emigrant i kthyer, punëtor emigrant	2
Ç	Familjet e policëve të rënë në detyrë	3
D	Viktima të dhunës në familje	5
E	Komuniteti Rom dhe Egjipian	2
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	30
A	Të ardhura nën 80% të të ardhurave mesatare	15
B	Të ardhura deri 80%- 100% të të ardhurave mesatare	10
C	Të ardhura 100%- 120% të të ardhurave mesatare	5

*Shpenzimet mujore të një familje bazë (me katër anëtar) në Tiranë sipas INSTAT janë 81,710 lekë

Në llogaritjen e pikëve për individët/familjet aplikuese, Komisioni i Strehimit duhet të marrë në konsideratë rregullat e mëposhtme:

- I.** Pikët maksimale që mund të përfitojë një individ/familje janë 100. Nuk mund të mblidhen brenda për brenda një kriteri pikët:
 1. Nga A deri në D të kriterit 1.1 - Kushtet e strehimit;
 2. Nga A deri në Ç të kriterit 1.2 - Kushtet familjare; dhe
 3. Nga A deri në C të kriterit 1.4 - Kushtet ekonomike.

- II.** Pikët nga A deri në D të kriterit 1.3 mund të mblidhen me njëra-tjetrën sipas rasteve më poshtë:
 1. Pika A mund të mblidhet me njërin prej rasteve si më poshtë:
 - a) Me pikat B dhe Ç së bashku ose veçmas;
 - b) Vetëm me pikën C;
 - c) Vetëm me pikën D.
 2. Pika B mund të mblidhet vetëm me pikën A.
 3. Pika C mund të mblidhet vetëm me pikën A.

4. Pika Ç mund të mblidhet me pikat A e B së bashku ose me njëren prej tyre. Në total mbledhja e pikëve A, B e Ç nuk duhet të rezultojë më e lartë se 20 pikë.

Procesi i përzgjedhjes finalizohet me zbardhjen e procesverbalit përkatës pjesë e të cilit është edhe lista përfundimtare të aplikantëve dhe përfituesve. Komisioni i Strehimit do t'i përcjell/vendos në dispozicion Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale procesverbalin sëbashku me listën e përfundimtare të përfituesve. Njëkohësisht, Komisioni i Strehimit do të hartojë Raportin Përmbledhës i cili do t'i paraqitet për miratim Kryetarit të Bashkisë.

Mbi bazën e Raportit Përmbledhës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale do të marrë masa për hartimin e listës përfundimtare të përfituesve dhe projekt-vendimit për miratimin e saj në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak.

Pas miratimit të listës përfundimtare nga Këshilli Bashkiak, ajo do të bëhet publike (në stendën e buletinëve, faqen e internetit të Bashkisë, dhe vende të tjera publike) si dhe një kopje e saj do ti dërgohet zyrtarisht Bankës së përzgjedhur, për vazhdimin e procedurave.

Përfituesit e miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak, të cilëve rezultojnë përfitues në një program të ndryshëm strehimi në momentin që i akordohet kredia hipotekore nga banka, duhet të paraqesin një deklaratë për heqjen dorë nga njëri prej këtyre programeve.

Nëse kjo deklaratë nuk paraqitet brenda një afati 10 ditor, përfituesi i kredituar nga banka humbet të drejtën e përfitimit nga programi tjetër i strehimit.

8. Skema e suvencionimit të interesave të kredisë dhe kufijtë minimal dhe maksimal të ardhurave që duhet të plotësojnë aplikuesit

Përcaktimi i kushteve për familjet që do të përfitojnë kredi të lehtësuara me mbështetjen e Bashkisë së Tiranës, është bazuar në të dhënat e marra nga EKB (Enti Kombëtar i Banësive), kriteret e kredidhënies të bankave të nivelit të dytë mbi nivelin e të ardhurave të kredimarrësit, INSTAT (buxheti i familjes), udhëzime dhe praktika të mëparshme me këtë objekt.

Kushtet e përgjithshme për përfitimin e kredive të lehtësuara, lidhur me të ardhurat minimum dhe maksimum të përfituesve potencial dhe shumën e përfituar të kredisë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3 - Të ardhurat minimum dhe maksimum të përfituesve potencial

			Rasti 1 - n=20, i=3 %		Rasti 2 - n=15 i=3 %	
Struktura e familjes	Struktura e Apartamentit	Kufiri Maksimal i Kreditimit	Te ardhurat Minimale	Te ardhurat Maksimale	Te ardhurat Minimale	Te ardhurat Maksimale
1-3	Gasoniere	3,565,000	39,543	65,905	49,238	82,064
2-4	1+1	4,278,000	47,451	79,086	59,086	98,477
4-6	2+1	5,704,000	63,269	105,448	78,782	131,303
mbi 5	3+1	7,130,000	79,086	131,809	98,477	164,128

Metodologjia e ndjekur në llogaritjen e kufirit maksimal të kreditimit dhe kufijtë minimal dhe maksimal të ardhurave që duhet të plotësojnë aplikuesit për efekt përfitimi, është si më poshtë vijon:

a. Vlera e Strukturës (apartamenteve) është llogaritur në bazë të çmimit mesatar (lekë/m²) për Tiranën dhe sipërfaqes mesatare sipas strukturës së apartamentit. Për përcaktimin e cmimit mesatar të apartamenteve, referencë është marrë vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë, e përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015. Siperfaqja mesatare e apartamenteve i referohet standarteve të ndërtimit.

b. Mbështur në kriteret e kredihënies, të përcaktuara nga bankat e nivelit të dytë por gjithashtu edhe në udhëzimin nr. 4441/2 datë 19.11.2014, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për individët/familjet që përfitojnë kredi të lehtësuar nga shteti”, kufiri maksimal i kreditimit për familjet llogaritet deri në 80% të vlerës së pasurisë (bazuar tek kontrata e shitjes). Nisur nga ky kriter është përlllogaritur masa e kredisë që do të përfitojnë kredimarrësit.

Procedurat e brendshme të bankave përcaktojnë përqindjen e të ardhurave mujore që zë kësti mujor i kredisë. Kjo përqindje mund të variojë nga 30% deri në 50%.

c. Përcaktimi i të ardhurave minimale(Amin) dhe maksimale(Amax) për përfituesit e kredisë është llogaritur duke u bazuar edhe në formulat shembull të programeve të tjera të ngjashme dhe duke iu referuar kryesisht nenit 19 të ligjit mbi strehimin. Sipas nenit 19, por edhe procedurave të brendshme të bankave të nivelit të dytë, llogaritet që kësti mujor për kredimarrësit të jetë jo më i lartë se 50% e të ardhurave mujore dhe jo më i ulët se 30% e të ardhurave mujore. Në këtë mënyrë, kufiri maksimal i të ardhurave është përcaktuar si i barabartë me 70% të të ardhurave mujore duke supozuar se 30% e të ardhurave mujore shkojnë për pagesën e këstit mujor, ndërkohë që kufiri minimal i të ardhurave

është përcaktuar si i barabartë me 50% e të ardhurave duke supozuar që 50% e të ardhurave shkon për pagesën e këstit mujor të kredisë.

Duke marrë në konsideratë një nivel mesatar të nivelit të interesit në Bankat e Niveleve të II-ta që operojnë në Shqipëri, programi synon subvencionimin e interesave të kredisë duke siguruar për aplikantët akordimin e një kredie me interes fiks prej maksimalisht 3% (niveli i interesit do të mund të jetë në një interval nga 2.7 %-3%, variacion i cili do të jetë i përcaktuar saktësisht në marrëveshjen që Bashkia e Tiranës do të lidhë me Bankën e Nivelit të II-të). Bashkia e Tiranës merr përsipër subvencionimin e pjesës tjetër të interesit i cili do të jetë variabël, në varësi kjo të Marrëveshjes me Bankën e Nivelit të II-të dhe interesave të tregut të aplikueshme prej këtyre të fundit.

Tabela nr. 4 - Të dhënat bazë dhe përlogaritjet sipas përshkrimit të metodologjisë së ndjekur paraqiten në tabelën në vijim:

							Rasti 1.1 n=20, i=3 %	Rasti 1.2 n=15 i=3 %	
Struktura e ap.	Sip. Mes.	VI. Strukture	Pagesat mujore (3% interes)	50% te te ardhura e ze kesti mujor (MIN)	30% te te ardhura e ze kesti mujor (MAX)	Kufiri maksimal I Kreditimit	Pagesat Mujore 80% vleres (3% interes)	Pagesat Mujore 80% vleres (3% interes)	Shpenzime 2015 Instat
Gasoniere	50	4,456,250	24,714	49,429	82,381	3,565,000	19,771	24,619	56,201
1+1	60	5,347,500	29,657	59,314	98,857	4,278,000	23,726	29,543	74,197
2+1	80	7,130,000	39,543	79,086	131,809	5,704,000	31,634	39,391	87,833
3+1	100	8,912,500	49,429	98,857	164,762	7,130,000	39,543	49,238	93,908

9. Marrëveshja me Bankën e Nivelit të Dytë

Bashkia e Tiranës do të organizojë punën për përzgjedhjen e bankës që do të kreditojnë familjet. Përzgjedhja e bankës bëhet nëpërmjet një oferte publike dhe transparente, e cila u vihet në dispozicion të gjitha bankave që kryejnë shërbime në territorin e Republikës së Shqipërisë, së bashku me kriteret e përzgjedhjes së ofertës fituese. Në përfundim të këtij procesit Kryetari i Bashkisë do të lidhë marrëveshjen me bankën e përzgjedhur për kreditim.

Procedura për përzgjedhjen e bankës dhe lidhja e marrëveshjes përkatëse duhet të ketë përfunduar para shpalljes së njoftimit të parë publik (thirrjes së pare për aplikim).

Pas ezaurimit të të gjithë hapave të procesit për aplikantët e thirrjes së pare dhe lidhjes së marrëveshjes përkatëse me bankën e përzgjedhur, Bashkia e Tiranës ka të drejtë:

- (i) të rishikojë në çdo moment marrëveshjen ekzistuese me bankën e përzgjedhur për kreditimin: ose
- (ii) të lidhi një kontratë të re me bankë tjetër, që ofron kushte më të leverdisshme, pa cenuar kushtet e marrëveshjes së lidhur me bankën e përzgjedhur fillimisht.

10. Monitorimi i ecurisë së programit të strehimit social

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale i njofton Bankës së Nivelit të dytë me te cilën ka lidhur marrëveshjen e bashkëpunimit, listën e perfituesve të miratuar nga Këshilli Bashkiak të brenda 10 ditëve nga hyrja ne fuqi e këtij të fundit.

Çdo tre muaj Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale i kërkon Bankës informacion mbi e ecurinë e procedurave të akordimit të kredise përfituesve dhe ecurinë disbursimit të kredive të akorduara.

Çdo tre muaj Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale i raporton Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar rezultatet e monitorimit.

11. Anekset

Anekset e listuara në vijim i bashkëlidhen Udhëzuesit Operacional dhe konsiderohen pjesë përbërse e tij:

- a. Aneksi nr. 1 - Njoftimi Publik;
- b. Aneksi nr. 2 - Forulari i Strehimit;
- c. Aneksi nr. 3 - Procesverbali i vlerësimit të aplikimeve.

Aneksi nr:1

Njoftimi publik

Bazuar në vendimin e Këshillit Bashkiak me nr _____, datë __, __, 2017, Për miratimin e Programit Social të Strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë” njoftohen të gjithë qytetarët e interesuar të paraqesin aplikimet e tyre për “Programin Social të Strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë”” pranë Bashkisë Tiranë për nga data _____ deri më _____ .

Programi Social i Strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë” synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.

Kriteret bazë për paraseleksionimin e kërkesës së paraqitur nga individët/familjet e interesuara për të përfituar nga programi social i strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë”, do të jenë:

- ✓ individë të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë mbushur moshën 18 vjeç;
- ✓ familjet të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kanë në pronësi një banesë;
- ✓ familjet që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;
- ✓ familjet që zotërojnë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

			Rasti 1 - n=20, i=3 %		Rasti 2 - n=15 i=3 %	
Struktura e familjes	Struktura e Apartamentit	Kufiri Maksimal i Kreditimit	Te ardhurat Minimale	Te ardhurat Maksimale	Te ardhurat Minimale	Te ardhurat Maksimale
1-3	Gasoniere	3,565,000	39,543	65,905	49,238	82,064
2-4	1+1	4,278,000	47,451	79,086	59,086	98,477
4-6	2+1	5,704,000	63,269	105,448	78,782	131,303
mbi 5	3+1	7,130,000	79,086	131,809	98,477	164,128

Formulari i Aplikimit së bashku me dokumentacionin e kërkuar duhet të dorëzohen në kopje origjinale personalisht pranë Zyrave të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës ose nëpërmjet postës në një zarf të vulosur që drejtohet si më poshtë: “Në vemendje të:” Drejtorisë së Strehimit - Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Bashkia e Tiranës” .

Çdo aplikant sëbashku me kërkesën e tij duhet të dorëzojë edhe dokumentat si më poshtë:

- (i) Formulari i strehimit i plotësuar pranë Njesisë Administrative në të cilën aplikantit ka vendbanimin;
- (ii) Çertifikatën e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare;
- (iii) Vërtetimin për vendbanimin në bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;
- (iv) Vërtetimin e të ardhurave neto të familjes/individit;
- (v) Dokumentacionin përkatës nga punëdhënësi për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;
- (vi) Dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
- (vii) Vërtetimin nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të qeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në pagesat për personat me aftësi të ku fizuar;
- (viii) Vërtetimin nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;
- (ix) Vërtetimin nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension;
- (x) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis, që mund të përdoret si e till
- (xi) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit;
- (xii) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
- (xiii) Dokumentin zyrtar të celebrimit dhe certifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja;
- (xiv) Vendimin e gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara;
- (xv) Vërtetimin përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit;
- (xvi) Vërtetimin e komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar, për individë me aftësi të kufizuara;
- (xvii) Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", punëtor emigrant" dhe "azilkërkues";
- (xviii) Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Policisë së Burgjeve;
- (xix) Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse për viktimat e dhunës në familje punëtor emigrant" dhe "azilkërkues";
- (xx) Deklarate noteriale që lëshohet nga kryefamiljari që shprehet se është dakort që kredia të lëvrohet për aplikantin që rezulton i përfshirë në formularin e strehimit.

Komisioni i Strehimit shqyrton aplikimet dhe përzgjedh aplikantët në bazë të sistemit të pikëzimit. Pas përfundimit të shqyrtimit të aplikimeve komisioni në fjalë harton një Raportit

Përmbledhës i cili i paraqitet në Këshilli Bashkiak, për miratimin e listave përfundimtare të përtitueve të programit socila të strehimit “Subvencionimi i Interesave të Kredive”.

Kundër Vendimit të Këshillit Bashkiak për “ Miratimin e listave të përfituesve të programit social të strehimit për “Subvencionimin e Interesave të Kredive të Buta”” mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente.

Aneksi nr. 2

Formulari i Strehimit i cili plotësohet pranë Njesisë Administrative të aplikantit

KËRKESE

FAZA E PARË E APLIKIMIT

Mbiemri.....emri.....datëlindja.....

Qyteti.....Njësia administrative.....Rruga.....

Pall.Shk.Ap.(Në rastin e një banese privat) Nr.Tel.

I. GJENDJA FAMILJARE

MBIEMRI	EMRI	DATËLINDJA Dita/Muaji/Viti (00/00/00)	(1) SEKSI	(2) GJENDJA CIVILE	Nr. DOKUMENTI I IDENTIFIKIMIT	(3) FAMILJARËT	(4) PUNËSIMI

<u>1. SEKSI</u>		<u>2. GJENDJA CIVILE</u>		<u>3. FAMILJARËT</u>		<u>4. PUNËSIMI</u>	
Mashkull	M	Beqar/e	1	Aplikanti	00	Punësuar në shtet	01
Femer	F	I/e martuar	2	nëna/baba	01	Punësuar në privat	02
		I/e ve	3	Bashkëshorti/ja	02	Vetëpunësuar	03
		I/e divorcuar	4	biri/bija	04	Punësim i rastit	04
				gjysh/e	05	i përfshirë në programin e ndihmës ekonomike	05
				nip/mbesë	06	i përfshirë në programin e pagesës së papunësisë	06
				vjerri/a	07	Të tjerë.	07
				Dhëndri/nusja	08		
				Vëllai/motra	09		
				Kunati/a	10		
				Të tjerë	11		

Shënim: Në kolumnat 1,2,3 dhe 4 vendos numrin që i korrespondon gjëndjes suaj. Të dhënat e kolonës (3) duhet të korrespondojnë me çertifikatën familjare.

II. GJENDJA E STREHIMIT

	Jo	Po
1. Përfitur banesë nga ligji Nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore".....	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2. Disponon banesë në pronësi.....	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2.1. Nëse po jep informacionin e saktë mbi:

- Prona është e regjistruar në emër të (vendos referencën sipas kolonës (3) të tabelës "Gjendja familjare" _____

1+1.....
- Struktura e apartamentit

2+1.....
- Struktura e apartamentit

3+1.....
- Struktura e apartamentit

- Sipërfaqe totale e banesës sipas dokumentit të pronësisë.....

- Sipërfaqja totale e banimit'

3. Nëse jeni përgjegjor negativisht në pikën (2) vazhdoni plotësimin e informacionit më poshtë:

- Banoj me qira.....

- Disponoj objekt tjetër në pronësi që mund të përdoret edhe për strehim

Nëse po, jep informacion të saktë mbi:.

- Llojin e objektit.....

- Sipërfaqen totale të objektit.....

Kushtet e banimit:

- Kushte të këqia higjeno shëndetësore.....	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
- banesë me rrezik shëmbje.....	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
- banesë e mbipopulluar.....	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

III. TE ARDHURAT E FAMILJES

Ky seksion duhet të plotësohet për çdo person që siguron një të ardhur në familje në përputhje me kolonat (3) e (4) të tabelës "Gjendja Familjare". Në të ardhura totale të familjes përfshihen të ardhurat neto nga punësimi, dypunësimi, pagesa e papunësisë, pagesa e ndihmës ekonomike, pensioni, dërgesa nga emigracioni, qira nga prona. Transferta të tjera nga të afërm, si dhe çdo lloj e ardhure tjetër që sigurohet mbi baza mujore ose vjetore nga trashëgimi, interesa bankare, etj. Me të ardhura neto kuptohen të ardhurat pas shlyerjes së detyrimeve si taksa, tatime e sigurime shoqërore.

' Në sipërfaqe totale të banimit futen sipërfaqja e dhomave të gjumit plus sipërfaqen e dhomës së ditës, të matura brënda mureve ndarës.

- Të ardhurat totale të familjes.....

- Të dhëna të detajuara të të ardhurave mujore të familjarëve sipas kolonës (3) të tabelës "Gjendja Familjare"

- 00..... 04..... 08.....

- 01..... 05..... 09.....

- 02..... 06..... 10.....

- 03..... 07..... 11.....

- Të ardhura nga emigracioni (vjetore).....

- Të ardhura nga qira (mujore).....

- Të ardhura të tjera (vjetore).....

IV. KËRKESË E VEÇANTË PËR STATUSIN E NJËRIT PREJ ANËTARËVE TË FAMILJES

1. A ka në përbërjen tuaj familjare persona me aftësi të kufizuara sipas kategorive të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas nenit 5 të nr. 9232, datë 13.05.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane" (i ndryshuar):

Jo **Po**

Nëse po, atëherë cilësoni kategorinë _____

	PO	JO
2. A ka në përbërjen tuaj familjare persona me statusin:		
- emigrant i rikthyer.....	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
- puntor emigrant.....	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3. A dispononi statusin e jetimit.....	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4. A jeni viktmë e dhunës në familje	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5. A jeni familje e policëve të rënë në detyrë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

VI. DEKLARATË E VËRTETËSISË SË INFORMACIONIT PARAPRAK

DEKLARATE

Nën përgjegjësinë time personale dhe në prani të punonjësit të njësisë së qeverisjes vendore, deklaroj sa më poshtë:

1. I gjithë informacioni i dhënë në formularin “ Kërkesë për aplikim për Programin Social të Strehimit “Subvencionimi i Interesave të Kredisë”” është i vërtetë.

2. Pranoj që, në rast se përzgjidhem për t'u trajtuar me këtë program, të bëhet inspektimi në banesën ku banoj dhe verifikimi i të gjithë informacionit të dhënë.

3. Jam në dijeni se për çdo informacion të rremë, mua dhe anëtarëve të familjes sime, u hiqet e drejta për të përfituar nga ky program.

Nënshkruar në _____, më _____

Deklaruesi: (Emër/Mbiemër/Firmë) _____

Punonjësi i njësisë së qeverisjes vendore: (Emër/Mbiemër/Firmë) _____

Shënim: Në prani të punonjësit të qeverisjes vendore firmoset vetëm deklarata.

Aneksi Nr. 3

Procesverbali i Vlerësimit të Aplikimit

Procesverbal

Procesverbal i mbajtur sot në datë....., në prani të antarëve 1, 2, 3, 4,,,,,, të pranishëm nga 1, 2, 3....., të njoftuar nëpërmjet shkresës me nr. Prot..... datë me lëndë “ Për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar për aplikimin në Programin Social të Strehimit “ Subvencionimi i Interesave të Kredisë””, praën Bashkisë së Tirnës. .

U morën në shqyrtim aplikime, nga të cilat, rezultuan:

1. Aplikime me dokumentacion të rregullt _____
2. Aplikime të cilat nuk kanë plotësuar fazën e parë të aplikimit pranë Njesisë Administrative _____
3. Aplikime me mungesë në dokumentacion _____
4. Aplikime të cialt kanë të ardhura mbi nivelin e përcaktuar të të ardhurave _____
5. Aplikime të cialt kanë të ardhura nën nivelin e përcaktuar të të ardhurave _____

Komisioni i Strehimit pasi vlerësoi të gjitha dosjet në unanimitet i propozon Kryetarit të Bashkisë të propozoj për miratim në Këshillin Bashkiak listën me përfituesit e Programit Social të Strehimit “ Subvencionimi i Interesave të Kredisë”, si më poshtë vijon:

1.
2.
3.
4. etj.